



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
KRYETARI

Nr 852/7 prot.

Tiranë, më 23 . 11 . 2017

UDHËZIM
Nr 230 , datë 23.11.2017

**“PËR ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE LIDHUR
ME KRYERJEN E VEPRIMEVE PARAPRAKE PËR KOMUNIKIMIN E PADISË DHE
TË AKTEVE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, gërma “dh”, në të cilin parashikohen kompetencat e Kryetarit të Gjykatës, në nenin 4 i cili parashikon se në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor dhe se çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit, në nenin 5, i cili parashikon “ Aksesin në gjykata” sipas të cilit :

- Çdo person trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat.
- Çdo person ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore, siç parashikohet me ligj.
- Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente të shpejtë dhe efikase,

në Kodin e Procedurës Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 338/2017, Pjesa e Dytë, Titulli I “PARAQITJA E PADISË, DEKLARATA E MBROJTJES DHE VEPRIMET PËRGATITORE” nenet 154-158/ç, si dhe nenin 25 të po këtij kodi i cili parashikon se “ Është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim”,

UDHËZOJ

1. Komunikimi i kërkesëpadisë dhe akteve provuese/gjyqësore bashkëlidhur duhet t’i komunikohen palëve në proces sipas cilësisë që ligji u ka njohur përkatësisht, nëpërmjet dëftesës së komunikimit në përputhje me formatet që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

2. Dëftesat e komunikimit do t'i njoftohen palëve, nga ftuesit e gjykatës ose nëpërmjet postës, duke ndjekur të njëjtën procedurë si me fletëthirrjet. Dëftesa e komunikimit merr numër akti atë të dosjes gjyqësore dhe nuk përcillet me anë të protokollit. Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve ARK IT do të konfigurujë fletëthirrjen e sistemit sipas kërkesave të reja procedurale të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar.
3. Udhëzohen gjyqtarët e Dhomës Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të unifikojnë zbatimin dhe kryerjen e veprimeve procedurale të para fillimit të seancës gjyqësore, me qëllim që palët të kenë të njëjtën qasje ndaj gjykatës sa herë që i drejtohen për realizimin e të drejtave të tyre. Gjyqtarët e Seksionit Familjar do të zbatojnë në mënyrë harmonike dispozitat e Kodit të Procedurës Civile me ato të Kodit Familjes duke patur parasysh veçoritë e çështjeve familjare.
4. Gjyqtarët udhëzohen që të informojnë palët për zgjidhjen e çështjes me marrëveshje nëpërmjet ndërmjetësimit, duke referuar tek lista e ndërmjetësve që është e afishuar në faqen zyrtare të gjykatës, kur palët e pranojnë atë.
5. Ngarkohet kancelari dhe kryesekretari për zbatimin e këtij urdhri dhe publikimin në faqen zyrtare të gjykatës.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

ENKELEDI HAJRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

NR.REGJ.THEM./VITI _____

DATA _____

DËFTESË KOMUNIKIMI

DREJTUAR PALËS SE PADITUR (Emër Atësi Mbiemër): _____
(EMERTIMI I PERSONIT JURIDIK)

ADRESA: _____

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është duke u shqyrtuar çështja me Nr.Regj.Them./viti _____.

Bazuar ne nenin 158 të K.Pr.Civile bashkëlidhur kësaj dëftese komunikimi janë aktet si vijon:

1. kërkesëpadia,
2. provat dhe akteve te tjera gjyqësore (nr. i fletëve gjithsej _____)

Me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës me numër akti _____, datë _____, palës së paditur i është **caktuar një afat** _____ (_____) ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të këtij akti, për paraqitjen e deklaratës se mbrojtjes. **MOSRESPEKTIMI I KËTIJ AFATI SJELL MOSPRANIMIN E KËSAJ DEKLARATE.**

GJYQTAR

Ftuesi gjyqësor
Emër mbiemër dhe nënshkrim

Mori dijeni¹
(Emër mbiemër dhe nënshkrim)

Dëshmitari i Pranishëm

Data e Njoftimit

_____ DATA _____

¹ Në të gjitha këto raste, kur personi që merr njoftimin nuk është pala e paditur, duhet të bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur.

Bazuar në nenin 158 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata i kërkon të paditurit të lëshojnë deklaratën e mbrojtjes, si vijon:

Deklarata e mbrojtjes hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë: a) gjykatën përpara së cilës paraqitet deklarata e mbrojtjes; b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka. Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi; c) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka.

Përveç këtyre kërkesave, i padituri deklaron qartë në/ose bashkëngjitur deklaratës së mbrojtjes: a) të dhënat e kontaktit të tij elektronik ose të përfaqësuesve të tij, nëse ka, të cilat gjykata mund t'i përdorë për ta njoftuar; b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, duke specifikuar saktë emrat e tyre, atësinë, mbiemrin, dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to; c) provat që kërkohen të

merren tek të tretët ose te paditësi, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave; ç) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit; d) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin e personit juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi; dh) **kundërpadinë, kur kërkohet prej tij ushtrimi i kësaj të drejte, sipas nenit 160 të këtij Kodi.**

GJYKATA JU INFORMON SE:

- Deklarata e mbrojtjes dhe provat duhet te paraqiten **në një kopje për secilin paditës.**
- Keni mundësinë për të kërkuar **ndihmë ligjore.**
- Duhet të informoni gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik për vete ose përfaqësuesin e tij. Shkelja e këtij detyrimi i **bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.**
- Prapësimet dhe provat, që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesë të palëve, **nuk pranohen nga gjykata më pas, nëse nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes.**

- Mosparaqitja në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore pa shkak të ligjshëm, me kërkesë të paditësit, sjell si pasojë **zhvillimit e gjykimit në mungesë.** Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, gjykata **nuk njofton më palën që vendos të gjykojë në mungesë.**
- Pas urdhrorit të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, **nuk mund të kërkohen prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja,** përveçse rasteve përjashtimore te parashikuar nga neni 186 i Kodit të Procedurës Civile.

Informacioni më i detajuar mbi elementet përbërës të deklaratës së mbrojtjes, i vendosur në një format, gjendet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane www.gjykatatirana.gov.al

Palët njoftohen për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, nëpërmjet gjykatës, me anë të ndërmjetësit të zgjedhur nga lista për këtë qëllim. Shiko për më shumë informacion www.dhka.gov.al

DEKLARATA E MBROJTJES

Në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 158 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile

Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Gjyqtarit _____

NR.REGJ.THEM./VITI _____

Të dhëna për palën e paditur

Emri/ Mbiemri/ (ose emërtimi i personit juridik) _____

Kontaktet e përfaqësuesit (nëse ka)

Të dhënat e kontaktit të palës së paditur ose të përfaqësuesit të tij.

Nr. tel _____

E-mail _____

I. Rrethanat e Çështjes

Paraqisni faktet konkrete, rrethanat, prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse keni, si dhe dokumentet e provat e tjera, një kopje për secilin paditës . *(Duhet t'ia bashkëlidhni deklaratës në mënyrë të detajuar duke listuar provat)*

II. Lista e dëshmitarëve të palës së paditur

Emri/ Mbiemri Adresa _____ -

Fakti që do të provohet me dëshmitarë _____

III. Provat që kërkohen të merren tek personat e tretë _____

Arsyeja e marrjes së provave _____

Vendndodhja e provave _____

IV. Lloji i ekspertimit që kërkoni të kryeni gjatë gjykimit _____

V. Personat e tretë që kërkoni të thirren gjatë gjykimit

Emri/ Mbiemri (ose emërtimi i personit juridik)/ Adresa

Deklaratës duhet t'i bashkëlidhni edhe kundërpadinë (nëse keni) sipas nenit 160 të K.Pr.Civile.

EMËR MBIEMËR

**INFORMACION MBI ELEMENTËT PËRBËRËS TË NEVOJSHËM TË
DEKLARATËS SË MBROJTJES¹**

PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

TË PËRBËRË NGA GJYQTARI/E E ÇËSHTJES

NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN CIVILE NR.REGJ.THEM _____, DATË _____,

NE CILËSINË E PALËS SË PADITUR ME GJENERALITETET SI VIJON:

I/TË PADITUR/IT (emrin, mbiemrin, atësinë, amësinë, datëlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimi e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka)

(nëse i padituri është person juridik, emërtimin e tij, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ashtu siç figuron në regjistrat publikë, ku do kryhet njoftimi; përfaqësuesin ligjor; personat që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka)

(deklarimin e qartë të të paditurit në deklaratës së mbrojtjes ose bashkëngjitur saj, për të dhënat e kontaktit të tij elektronik ose të përfaqësuesve të tij, nëse ka, të cilat Gjykata mund t'i përdorë për ta njoftuar;)

po parashtroj para gjykimit Tuaj prapësimet e mia në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor te padisë, si me poshtë vijon:

1. (Do të filloni me tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka)

2. (Do të parashtroji provat (nëse ka), qe duhet t'i bashkëlidhen deklaratës së mbrojtjes, si vijon:

- Provat shkresore ose te tjera duhet të paraqiten veç e veç dhe në jo ne grup. Provat shkresore duhet te jene ne origjinal ose te njësuara me origjinalin. Parashtrimi i provave duhet bërë duke argumentuar, ne këtë deklaratë, objektin e te provuarit të secilës prej

¹ Hartohet vetëm në gjuhën shqipe

tyre në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor te padisë dhe të prapësimeve të paraqitura. Një kopje e tyre, (provat shkresore në formën fotokopje), për palën paditëse.

- listën e personave që kërkoni të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, duke specifikuar saktë emrat, atësinë, mbiemrin, dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me thirrjen e tyre. Për secilin dëshmitar të argumentohet objekti i te provuarit në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor te padisë dhe të prapësimeve të paraqitura,
- provat që kërkohen të merren tek të tretët ose tek paditësi, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave dhe pamundësinë e marrjes së tyre nga vetë i padituri. Për secilën nga këto prova të argumentohet objekti i te provuarit në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor te padisë dhe të prapësimeve të paraqitura,
- llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjyqimit në mbështetje të prapësimeve, duke argumentuar objektin e te provuarit;

3. (Kërkesën për thirrjen e personave të tretë (nëse ka), sipas nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile, duke përcaktuar:

- emrin, mbiemrin, atësinë, amësinë, datëlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimi (adresën e plotë) të personit/ave te tretë, që kërkon të thirren,
- nëse personi/at e tretë është/janë person juridik, emërtimin e tij, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ashtu siç figuron në regjistrat publikë, ku do kryhet njoftimi; përfaqësuesin ligjor; personat që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka)

(duke argumentuar arsyet për të cilat i padituri mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.)

4. (kërkesën për paraqitjen për shqyrtim të kundërpadisë së bashku me padinë, kur kërkohet ushtrimi i kësaj të drejte, sipas nenit 160 të këtij Kodi. Kundërpadia duhet të paraqitet me akt te veçantë, bashkëngjitur deklaratës së mbrojtjes ose derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të Kodit. Për ngritjen e kundërpadisë zbatohen rregullat për ngritjen e padisë, sipas neneve 153 e vijues të Kodit te Procedurës Civile.

5. Është detyrë e Gjykatës t’iu vërë në dijeni se ka për detyrim ligjor qe ne këtë fazë, të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

GJYKATA JU INFORMON SE:

- Deklarata e mbrojtjes dhe provat duhet te paraqiten **në një kopje për secilën palë paditëse.**
- Keni mundësinë për të kërkuar **ndihmë ligjore.**
- Duhet të informoni gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik për vete ose përfaqësuesin e tij. Shkelja e këtij detyrimi **i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.**
- Prapësimet dhe provat, që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesë të palëve, **nuk pranohen nga gjykata më pas, nëse nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes.**
- Mosparaqitja në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore pa shkak të ligjshëm, me kërkesë të paditësit, sjell si pasojë **zhvillimit e gjykimit në mungesë.** Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, gjykata **nuk njofton më palën që vendos të gjykojë në mungesë.**
- Pas urdhrit të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, **nuk mund të kërkohen prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja,** përveçse rasteve përjashtimore te parashikuar nga neni 186 i Kodit te Procedurës Civile.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

NR.REGJ.THEM./VITI _____

DATA _____

DËFTESË KOMUNIKIMI

DREJTUAR PERSONIT TË TRETË (Emër Atësi Mbiemër):

(EMËRTIMI I PERSONIT JURIDIK)

ADRESA: _____

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është duke u shqyrtuar çështja me nr.Regj.them./viti_____.Bazuar ne nenin 158 të K.Pr.Civile bashkëlidhur kësaj dëftese komunikimi janë aktet si vijon:

1. kërkesëpadia,
2. provat dhe akteve te tjera gjyqësore (nr. i fletëve gjithsej_____)

Me vendimin e ndërmjetëm te gjykatës me Nr. Akti _____, datë _____, personit të tretë **i është caktuar një afat** _____ (_____) **dite** nga dita e nesërme e njoftimit të këtij akti, për paraqitjen me shkrim te qëndrimit te tij ne lidhje me këtë padi dhe provat, nëse ka.

GJYQTAR/E

Ftuesi gjyqësor
Emër mbiemër dhe nënshkrim

Mori dijeni¹
(emër mbiemër dhe nënshkrim)

Dëshmitari i Pranishëm

Data e Njoftimit

DATA _____

¹ Në të gjitha këto raste, kur personi që merr njoftimin, nuk është pala e paditur duhet te bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

NR.REGJ.THEM./VITI _____

DATA _____

DËFTESË KOMUNIKIMI

DREJTUAR PADITËSIT / PERSONIT TË TRETË (Emër Atësi Mbiemër):

(EMËRTIMI I PERSONIT JURIDIK)

ADRESA: _____

Bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile bashkëlidhur kësaj dëftese komunikimi janë aktet si vijon:

1. Deklarata e mbrojtjes, provat dhe akteve të tjera gjyqësore(gjithsej _____ numri i fletëve).

Me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës me numër akti _____, datë _____, ju është **caktuar një afat** _____ (_____) ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të këtij akti, për të paraqitur prova të tjera që lidhen me prapësimet e reja të të paditurit të parashtruara në deklaratën e mbrojtjes, nëse ka.

GJYQTAR/E

Ftuesi gjyqësor
Emër mbiemër dhe nënshkrim

Mori dijani¹
(emër mbiemër dhe nënshkrim)

Dëshmitari i Pranishëm

Data e Njoftimit

DATA _____

¹ Në të gjitha këto raste, kur personi që merr njoftimin nuk është pala e paditur, duhet të bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE**

NR.RREGJ.THEM./VITI_____

**V E N D I M
“PER VEPRIMET PARAPRAKE”**

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE, E PËRBËRË NGA:

– GJYQTAR/E

sot me datë _____ mori në shqyrtim në veprime paraprake, pa praninë e palëve, çështjen civile Nr. _____, që i përket:

PADITES:

E PADITUR:

PERSONA TE TRETE:

OBJEKTI:

Gjykata, pasi u njoh me padinë dhe me aktet bashkëlidhur saj;

V Ë R E N

Gjykata pas njohjes me kërkesëpadinë e paraqitur dhe te akteve bashkëlidhur, çmon se padia e paraqitur, deri ne këtë moment, vlerësohet si pa të meta sipas neneve 154/a dhe 156 të këtij Kodi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 4 dhe 158 e vijues te Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

1. Bashkimin e padive në një gjykim të vetëm në rastet e parashikuara në këtë Kod ose për veçimin e kërtimeve.
2. Përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës (kur janë rastet e përcaktuara me ligj dhe është bërë kërkesë nga paditësi)
3. Thirrjen e personit të tretë në gjykim, sipas nenit 193 të këtij Kodi.
4. Njoftimin e kërkesëpadisë dhe të një kopje e provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur, Avokaturës së Shtetit (nëse duhet sipas 79/a) dhe personave të treta.
5. Bashke me njoftimin të komunikohet dhe kërkesa sipas ligjit, mbi elementet përbërës të deklaratës së mbrojtjes, i vendosur në një format, i cili mund të shërbejë si shembull për t'u plotësuar nga i padituri.
6. Të gjitha provat sipas pikës 4 të këtij vendimi të listohen me shkrim dhe një kopje t'i komunikohet palës së paditur Avokaturës së Shtetit (nëse duhet sipas 79/a) dhe personave të treta.
7. Palës së paditur i caktohet në afat _____dite, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes.
8. Personit të tretë i caktohet në afat _____dite, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur, për mbajtje të qëndrimit me shkrim ndaj padisë dhe paraqitjen e provave nëse ka.
9. Palës paditëse i caktohet një afat _____, nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes dhe provave të të paditurit, për të paraqitur prova të tjera që lidhen me prapësimet e të paditurit të parashtruara në deklaratën e mbrojtjes.
10. Bazuar në kërkesën e paditësit, pranimin e kërkesës për kryerjen e një akti ekspertimi në fushën e _____ dhe caktimin nga lista përkatëse e ekspertit_____. Një ekstrakt i këtij vendimi dhe i datës së veprimeve përgatitore për caktim ekspert, t'i njoftohet palëve ndërgjyqëse (paditës i paditur) dhe ekspertit.
11. Bazuar në nenin 223, 224 të Kodit të Procedurës Civile urdhërohet (marrja e provave tek të tretet sipas kërkesës së paditësit). Një ekstrakt i këtij vendimi t'i dërgohet personit të urdhëruar për njoftim.
12. Të caktoje datën_____ për zhvillimin e seancës përgatitore për marrjen në shqyrtim të kërkesës për:
 - Sigurim padie (kur çmon se duhet të shqyrtohet në prani të palëve)
 - ndërhyrje kryesore,
 - ndërhyrje dytësore,
 - zëvendësim procedural,
 - kalim procedural,
 - ndryshimin e shkakut ose
 - shtimin, pakësimin ose ndryshimin e objektit të padisë,
 - paraqitjen e kundërpadiës, si dhe

- caktimin e ekspertit
- çmohet nevoja e thirrjes dhe dëgjimit të palëve.

13. Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimet sipas këtij vendimi.

Tirane, sot me datë _____

GJYQTARI/E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

U R D H Ë R

“PËR CAKTIMIN E SEANCËS GJYQËSORE”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRË NGA:

GJYQTARI/E: _____

sot më datë _____,

V E R E N

Se janë kryer të gjitha veprimet paraprake dhe /ose përgatitore të nevojshme, në lidhje me çështjen civile Nr. _____, datë regjistrimi _____,

PËR KËTO ARSYE

Në zbatim të neni 158/c të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata

U R D H Ë R O N

1. Caktimin e seancës së parë gjyqësore me **datë** ____/____/_____, **ora** _____, **salla** _____, **kati** _____.
2. Palët që kërkohen të pyeten nga Gjykata sipas nenit 182 të Kodit të Procedurës Civile janë:
 - a) _____(për secilën palë duhet të përcaktohen rrethanat për të cilat ato duhet të pyeten personalisht)
 - b)
 - c) Qëndrimi i palës do të vlerësohet nga Gjykata në përputhje me nenin 182 dhe nenet 281 – 285 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Dëshmitarët (nëse ka), që duhet të marrin pjesë në seancë gjyqësore janë:
 - a) _____
 - b)

Bazuar ne nenin 165 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi duhet të përmbajë paralajmërimin e dëshmitarit për dënimin e tij me gjobë deri në 100,000 lekë dhe

sjelljen e tij me detyrim nga Policia e Shtetit, në rast se nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme. Njoftimi i dëshmitarëve bëhet me anë të postës,/ftuesit gjyqësor.

4. Eksperti/grupi i ekspertëve të caktuar nga Gjykata është/janë:

a) _____

b)

Bazuar në nenin 165 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi duhet të përmbajë paralajmërimin e ekspertit për dënimin e tij me gjobë deri në 100,000 lekë dhe sjelljen e tij me detyrim nga Policia e Shtetit, në rast se nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme. Njoftimi i ekspertëve bëhet me anë të postës,/ftuesit gjyqësor/e-mail/telefon.

5. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet palëve dhe personave të tretë.

6. Njoftimi i personave, të përcaktuar në pikën 5 të vendimit, të kryhet me mënyrën e fundit të njoftimit të tyre gjatë veprimeve paraprake/përgatitore, me të cilin ata kanë marrë dijeni.

7. Urdhërohet sekretaria gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.

8. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet anëtarëve të tjerë të trupit gjykues (në rast se gjykimi do të zhvillohet me tre anëtarë).

Tiranë, sot më datë ____/____/_____.

GJYQTARI